



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.07.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

**Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit
dhe kryetar i grupit “Miqtë e fëmijëve”**

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 18.03.2018 dhe 28.06.2018.
2. Prezantimi i raportit të UNHCR-së dhe UNICEF-it, realizuar nga TLAS-i, për situatën e pashtetësisë në Shqipëri nga ekspertët: Lorena Isla Rodriguez (UNHCR) – Vangjel Kosta dhe Viktor Gumi (TLAS).
3. Pyetje/përgjigje dhe diskutime rreth raportit.
4. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Gramoz Ruçi, Vasilika Hysi, Elona Hoxha Gjebrea, Klodiana Spahiu, Antoneta Dhima, Milva Ekonomi, Elisa Spiropali, Ervin Bushati, Nora Malaj, Edlira Bode, Musa Ulqini dhe Ismet Beqiraj.

Të ftuar:

Pablo Zapata Olivares – Ambasador i UNHCR-së për Shqipërinë

Pandeli Majko – Ministër i Shtetit për Diasporën

Dritan Delija – Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë Kombëtare për Diasporën

Artemis Dralo – Zëvendësministre për Europën dhe Punët e Jashtme

Romina Kuko – Zëvendësministre e Punëve të Brendshme

Besa Shahini – Zëvendësministre e Arsimit, Rinisë dhe Sportit

Bardhylka Kospiri – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Teuta Vodo – Zëvendësministre e Drejtësisë

Erinda Ballanca – Avokat i Popullit

Nejla Peka – Komisionere për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Robert Gajda – Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Brunilda Paskali – Këshilltare e Presidentit të Republikës për Çështjet Sociale

Arda Hoxha – Përgjegjëse Sektori në Agjencinë për Mbrojtjen e Drejtave të Fëmijëve

Bledar Doracaj – Drejtor i Përgjithshëm i Gjendjes Civile

Edmond Gjolekaj – Përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile

Jawad Aslam – Zëvendëspërfaqësues i Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët në

Shqipëri (UNICEF)

David Gvineria – Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë UNICEF-it

Ina Verzivolli – Specialiste për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë UNICEF-it

Iva Zajmi – Eksperte për grupin e deputetëve “Miqtë e fëmijëve” pranë UNICEF-it

Hortens Balla – Zyrtar i Mbrojtjes pranë UNHCR-së

Artur Marku – Ndihmëszyrtar i Mbrojtjes dhe Informimit Publik pranë UNHCR-së

Valbona Dervishi – Koordinatore për përfshirjen sociale pranë PNUD-it

Rudina Brari – Eksperte pranë TLAS-it

Ermal Çomo – përkthyes pranë UNICEF-it

Lorena Isla Rodriguez – Eksperte e Agjencisë së Kombeve të Bashkuara për Refugjatët

(UNHCR)

Viktor Gumi – Ekspert pranë TLAS-it

Vangjel Kosta – Ekspert nga Shkolla e Magjistraturës/TLAS-i

HAPET TAKIMI

Gramoz Ruçi – Siç dihet, sot kemi takimin e anëtarëve të grupit “Miqtë e fëmijëve”. Ka mjaft të ftuar, kështu që unë do t’i falënderoja të gjithë, duke nisur nga ministri Majko dhe zëvendësministret që janë të pranishëm, ashtu si dhe përfaqësuesit e UNICEF-it dhe të UNHCR-së.

Të nderuar të ftuar,

Në cilësinë e kryetarit të këtij grupi, kam thirrur këtë mbledhje të radhës kushtuar prezantimit të raportit për situatën e pashtetësisë në Shqipëri.

Përpara se të vijojmë me rendin e ditës, do të dëshiroja shumë që ky organizëm i Kuvendit, në mbledhje pas mbledhjeje, të shtohet edhe më shumë, veçanërisht me deputetë të rinj. Prandaj dua ta përsëris thirrjen se të gjithë deputetët që kanë dëshirën, ndjeshmërinë dhe duan të kontribuojnë për të drejtat e fëmijëve janë të mirëpritur të bëhen pjesë e grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve” dhe, njëherazi, dua ta përgëzoj grupin “Miqtë e fëmijëve” për zhvillimin e aktiviteteve, sipas kalendarit që kemi miratuar, dhe ta inkurajoj atë për një angazhim më të madh në vijim të punës së tij!

Qëllimi ynë është avancimi i axhendës për projektimin e çështjes së fëmijëve për Kuvendin e Shqipërisë dhe plotësimin e detyrave që rrjedhin nga plani i punës dhe nga kalendarit i veprimtarive të grupit.

Sipas rregullave të funksionimit të këtij grupi, në takimin e radhës, sigurisht, miratohen formalisht procesverbalet e mbledhjeve të kaluara, respektivisht ai i datës 18.03.2018 dhe i datës 18.06.2018.

Ka vërejtje?

Meqenëse nuk ka ndonjë vërejtje për procesverbalet, i konsideroj ato të miratuara.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi prezantimin e raportit për situatën e pashtetësisë në Shqipëri. Raporti është përgatitur nga “Klinika ligjore falas, Tiranë”, me mbështetjen e agjencive të Kombeve të Bashkuara, UNICEF-it dhe UNHCR-së, në kuadër të koalicionit për të drejtat e çdo fëmije për shtetësi, veçanërisht ato që lidhen me parandalimin e pashtetësisë së fëmijëve, me qëllim adresimin e problematikave që hasin personat pa shtetësi, mendoj se ne duhet të veprojmë në tri drejtime.

Së pari, të përcaktojmë një procedurë të qartë për përcaktimin e pashtetësisë dhe mundësimin e regjistrimit ose lëshimit të dokumenteve të udhëtimit apo të qëndrimit për personat që e kanë këtë status.

Së dyti, të heqim dhe të lehtësojmë barrierat ligjore dhe ato administrative për të mundësuar regjistrimin e fëmijëve shqiptarë të lindur jashtë vendit apo edhe të atyre të lindur në Shqipëri, të cilët u përkasin kategorive të marginalizuara.

Së treti, të shikojmë njëherazi edhe tarifat e larta që i pengojnë prindërit nga familje të varfra që nuk regjistrojnë fëmijët e tyre.

Për këto arsye, në këtë mbledhje janë ftuar të marrin pjesë edhe disa ministra të linjës, përfaqësues të institucioneve të krijuara me ligj dhe agjenci shtetërore që kanë në fushën e tyre të përgjegjësisë çështjen, për të cilën diskutojmë sot, në mënyrë që të njihen me gjetjet e raportit e t'i adresojmë ato në mënyrën e duhur për zgjidhjen e të gjitha problematikave që ka identifikuar raporti.

Përpara se të kalojmë në prezantimin e raportit, kam kënaqësinë t'u jap fjalën përfaqësuesve të të dyja agjencive të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, në radhë të parë, ambasadorit të UNHCR-së, Shkëlqesisë së Tij, zotit Pablo Olivares.

Fjala është për ju, zoti Ambasador.

Pablo Olivares – Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar zotërinj përfaqësues të autoriteteve,

E nderuar zonja Nënkryetare,

Të nderuara zonja zëvendësministre,

I nderuar zoti Ministër,

Të nderuar deputetë,

Tani po vazhdoj më mirë në gjuhën angleze, sepse jam i kufizuar me fjalët në gjuhën shqipe.

Kjo është një fushatë që UNHCR-ja ka ndërmarrë dhe po drejton për eliminimin e të gjithë pashtetësisë deri në vitin 2024 në të gjithë botën, ku pjesë është edhe Shqipëria.

Ideja dhe arsyeja pse është marrë një fushatë e tillë është, sepse, sipas studimeve dhe punës kërkimore të UNHCR-së, aktualisht në botë janë 10 milionë njerëz, të cilët nuk gëzojnë shtetësinë e asnjë vendi. Kjo ka pasoja të tmerrshme për sa i përket gëzimit dhe respektimit të të drejtave të tyre dhe aksesit në shërbime, të cilat janë të nevojshme për një individ.

Faktikisht, ajo që tërhoqi vëmendjen tonë në Shqipëri ishin shifrat e censusit të fundit, që u bë për popullsinë e Shqipërisë, ku 7443 individë deklaruan vullnetarisht se ishin të paregjistruar. Kjo na bëri ta konsideronim dhe të bashkëpunonim me Shoqatën e Ndhmës

Ligjore, Tiranë dhe në diskutimet tona arritëm në përfundimin e marrjes së studimit që po prezantohet sot.

Menjëherë filluam bashkëpunimin me zyrën e gjendjes civile, drejtori i të cilës është prezent këtu, dhe i vumë vetes një afat 4 mujor për identifikimin e personave, të cilët nuk janë të regjistruar dhe që nuk kanë shtetësi. Brenda atyre 4 muajve ne arritëm të identifikojmë 1031 persona që nuk ishin të regjistruar. Tani ata janë identifikuar me emër dhe mbiemër.

Pas përfundimit të kësaj periudhe 4-mujore, ne vazhduam të merrnim kërkesa të tjera për identifikim. Brenda 2 muajve në vijim, të cilat nuk janë të përfshira në studim, as si pjesë kohore dhe as si shifra, 400 persona të tjerë erdhën vullnetarisht për t'u identifikuar. Kjo tregon shkallën e problemit. E rëndësishme është që të gjitha këto shifra janë identifikime që janë bërë vetëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Siç është diskutuar, ne nuk kemi marrë parasysh në këtë rast diasporën shqiptare, por duhet marrë në konsideratë që ka edhe fëmijë shqiptarë, të cilët jetojnë në diasporë, të cilët janë të paregjistruar dhe bëhen pjesë e këtij problemi.

Pyetja me të cilën unë do ta mbyll fjalën time është: çfarë duhet të bëjmë në këtë rast? Në këtë rast na duhet këshilla juaj, kështu që kemi ardhur këtu për të kërkuar ndihmën tuaj në këtë kuadër. Me partnerët tanë, zyrën e Avokatit të Popullit dhe atë të komisionerit kemi identifikuar disa ndryshime që mund të bëhen nga pikëpamja ligjore. Të njëjtën gjë e kemi bërë edhe me ministritë e linjës, por ekspertiza ligjore gjendet këtu, në këtë sallë. Këtë e kemi diskutuar me partnerët tanë dhe me të vërtetë në disa ligje kemi identifikuar disa nene që mund të kenë nevojë për ndryshime ose përmirësime, megjithatë, unë po jap një sugjerim pa pasur përvojën legislative. Atë përvojë e keni ju, prandaj, ne kemi ardhur këtu për të kërkuar ndihmën dhe të themi që të paktën kuadri ligjor për regjistrimin dhe për të gjitha çështjet e tjera që lidhen me këtë problematikë është zgjidhur. Dhënia fund rrezikut të pashtetësisë është e mundur dhe është në duart tona dhe tuajat.

Ju falenderoj jashtëzakonisht shumë për këtë takim dhe për mundësinë që më dhatë të jem këtu!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti ambasador!

Fjalën e ka zëvendëspërfaqësuesi i UNICEF-it, zoti Aslam.

Jawad Aslam – I nderuar Shkëlqesia juaj, Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar anëtarë të parlamentit dhe deputetë të Kuvendit të Shqipërisë,

Kolegë,

Zonja dhe zotërinj,

Faktikisht, edhe unë do ta doja që përshëndetjen time ta thosha në shqip, ashtu si edhe Pablo, por, fatkeqësisht, nuk jam akoma nën atë nivel edhe pse do të doja që një ditë të kisha mundësi të flisja në gjuhën tuaj shumë të bukur.

Jam me të vërtetë jashtëzakonisht shumë i kënaqur që jam pjesë e këtij takimi dhe dialogu për gjetjet kryesore të raportit të UNHCR-së “Hartëzimi i popullatës në rrezik të pashtetësisë në Shqipëri” dhe jam po ashtu i kënaqur që jam së bashku me grupin e deputetëve “Miq të Fëmijëve”.

Përpara se të kalojmë te pjesa e prezantimit dhe diskutimit që do të bëhet në kuadër të këtij raporti, dua të shpreh falënderimet e UNICEF-it për të gjithë deputetët nga të gjitha partitë politike, që janë pjesë e grupit të deputetëve “Miq të Fëmijëve”. Dua të falenderoj personalisht shkëlqesitë e tyre, Kryetarin dhe zëvendëskryetarin e Kuvendit për leadershipin dhe drejtimin e këtij grupi.

Për të diskutuar temën për të cilën jemi mbledhur sot dhe për të diskutuar rrezikun e pashtetësisë në Shqipëri, UNICEF mbështet qeverinë e Shqipërisë, UNHCR-në dhe Kuvendin e Shqipërisë në përpjekjet e tyre për të trajtuar këtë problem në vend. Janë parë disa përmirësime për sa i përket shifrave, megjithatë, siç edhe raporti e tregon, ka vend për përmirësim dhe problemi është akoma i gjallë.

Fatkeqësisht problemi i pashtetësisë prek më së shumti fëmijët. 96% e personave të paregjistruar janë nën moshën 18-vjeç. Shumica e këtyre personave vijnë nga grupe kryesisht të marginalizuara, që mund të jenë emigrantë, me etni rome ose egjiptiane apo grupe me gjendje shoqërore dhe ekonomike në varfëri.

Miq të nderuar, më lejoni të lexoj vetëm një nen të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, konkretisht nenin 7, që thotë si vijon: “Fëmija ka të drejtën e regjistrimit menjëherë pas lindjes dhe ka të drejtën që prej lindjes të ketë një emër dhe të ketë të drejtën të fitojë një kombësi”. Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve në rekomandimet e veta të vitit 2012 për Shqipërinë ka bërë disa rekomandime, por unë po citoj vetëm tre prej tyre.

1- Shteti palë duhet të vijojë të forcojë si përparësi përpjekjet e tij për të siguruar një sistem regjistrimi për të gjithë fëmijët e lindur në territorin e tij dhe regjistrimi të jetë pa pagesë.

2 – Komiteti inkurajon shtetin palë që të marrë masa proaktive, që synojnë kategoritë e fëmijëve me të cilat ka probleme në regjistrim.

3- Shteti palë duhet të ketë udhëzime të qarta për të gjitha shkollat në të gjithë territorin, që të gjithë fëmijët, pavarësisht statusit të tyre të regjistrimit, të regjistrohen në shkollat publike dhe që dështimi për të bërë një regjistrim të tillë mund të sjellë sanksione administrative.

Faktikisht, ne po punojmë me partnerët tanë për të parë ecurinë e shtetit për sa u përket këtyre rekomandimeve por, fatkeqësisht, duhet të themi që disa prej tyre nuk janë përmbushur akoma plotësisht.

Të nderuar deputetë dhe pjesëmarrës të parlamentit, UNICEF-i ju siguron që do të vazhdojë të punojë me ju dhe të ofrojë mbështetjen e tij dhe ju falënderon për mbështetjen tuaj në trajtimin e këtij problemi, që është faktikisht në të mirën e të gjithë publikut dhe për këtë mundësi diskutimi sot.

Faleminderit të gjithëve!

Gramoz Ruçi – I falenderoj zotërinjtë Olivares dhe Aslam!

Fjalën e kanë ekspertët për prezantimin e raportit të gjetjeve dhe sugjerimeve. Fillimisht fjalën e ka zonja Lorena Rodrigues, eksperte e UNHCR-së, më pas zoti Vangjel Kosta dhe mandej zoti Viktor Gumi. Mirë se erdhët në Kuvend, tashmë me status tjetër.

Lorena Rodrigues – Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë të OKB-së dhe pjesëmarrës të tjerë,

Shkurtimisht do të bëj një hyrje të prezantimit për studimin dhe pastaj do t'ia kalojë fjalën ekspertëve të tjerë.

Në këtë *slide* po paraqesim specifikat e demokrafisë për sa i përket këtij studimi. Gjëja e parë që është vënë re për sa i përket rrezikut të pashtetësisë, është që nuk ka një dallim të konsiderueshëm për sa i përket numrit të femrave dhe meshkujve, të cilët janë të ndikuar. Megjithatë, ashtu siç u përmend dhe u theksua edhe nga përfaqësuesi i UNICEF-it, zoti Aslam, 97% e personave në rrezik pashtetësie janë nën moshën 18 vjeç. Për sa u përket zonave ku individët në rrezik pashtetësie janë identifikuar në numra më të mëdhenj, duke pasur parasysh edhe popullsinë e zonës përkatëse, janë Gjirokastra, Berati, Shkodra dhe Tirana.

Siç mund ta imagjiloni, këtu bëhet edhe një lidhje me praninë e komuniteteve rome dhe egjiptiane në këto rrethe. Këto komunitete janë veçanërisht të ndikuara nga rreziku i pashtetësisë.

Në këtë *slide* jepet numri i individëve nën moshën 18 vjeç të identifikuar në kuadrin e këtij raporti. 50% e fëmijëve të identifikuar janë në moshën 0-5 vjeç, 37% e tyre janë në

moshën 6-14 vjeç, 10% e tyre janë në moshën 15-18 vjeç dhe pjesa tjetër prej 3% janë mbi moshën 18 vjeç. Faktikisht, këto janë arsyet që ata janë përmendur për mosregjistrimin e tyre me kombësinë shqiptare. Dua të theksoj se shumica e personave që janë identifikuar në kuadër të këtij studimi janë shtetas shqiptarë me ligj, por kombësia e tyre nuk është identifikuar akoma, prandaj këtë pjesë e quajmë në rrezik pashtetësie. 53% e atyre që janë identifikua në kuadër të këtij raporti kanë lindur jashtë Shqipërisë, kurse 12% kanë lindur jashtë rrethit martesor. Faktikisht, kjo shifër lidhet me prezumimin e atësisë, që është pjesë e Kodit Familjes dhe stigmatizimin në kuadër të këtij fenomeni. 10% kanë lindur jashtë sistemit shëndetësor, 9% kanë lindur në maternitet, kurse pjesa tjetër kanë arsye të ndryshme për mosregjistrimin, duke përfshirë këtu braktisjen ose vdekjen e njërit prej prindërve. Faktikisht, nëse do të theksonim dy tiparet kyçe ose më specifiket e këtij raporti, do të thoshim që shumica e këtyre personave janë fëmijë dhe shumica e tyre kanë lindur jashtë vendit. Normalisht, kjo lidhet edhe me regjistrimin në lindje.

Në këtë grafik të fundit do të shikoni përqindjet e personave që kanë deklaruar se kanë lindur jashtë Shqipërisë, të kategorizuar sipas vendeve të tyre të lindjes. Siç mund ta shikoni, pjesa më e madhe janë fëmijë që kanë lindur në Greqi, me 53%, ndjekur nga Gjermania, Kosova dhe më pas vendet e tjera, që kryesisht janë vende të Bashkimit Europian.

Unë po e mbyll këtu pjesën time të prezantimit për t'ua lënë radhën kolegëve të mi për problemet dhe rekomandimet në vijim.

Faleminderit!

Viktor Gumi - Faleminderit, i nderuar zoti Kryetar.

Bashkë me zotin Kosta kemi përgatitur një prezantim, të cilin do ta prezantoj unë.

I nderuar, zoti Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar të ftuar,

Kjo është me të vërtetë një çështje që meriton vëmendje të veçantë. Në titullin e *slide*-it vijues ne kemi paraqitur një nga konceptet që besojmë dhe gjykojmë që përbën misionin jo vetëm të shoqërisë që ne përfaqësojmë, Shërbimit Ligjor Falas, por njëkohësisht të çdo shoqërie, por edhe të administratës shtetërore: të drejtën për të pasur të drejta. Në fund të ditës, misioni që kemi është të realizojmë një nga të drejtat më bazike të këtyre individëve, sepse prej saj burojnë një sërë të drejtash të tjera.

Më poshtë, përpos titullit dhe misionit, kemi prezantuar një kazus, i cili përbën sfidën e përhershme, që gjendet jo vetëm nga shërbimi ligjor falas, por nga një sërë organizatash të

tjera që merren në këtë drejtim dhe që besojmë se deri në këtë moment është ende sfidë e pazgjidhur.

Shtetësja Z.M ka jetuar për një kohë të gjatë në Greqi, nga viti 1996 deri në vitin 2010. Nga një lidhje jashtëmartesore, në gusht të vitit 1999 ajo ka lindur në Greqi djalin e saj K.iks. Në spital ka deklaruar emrin e saj, por mbiemrin e bashkëjetuesit. Ky fëmijë është regjistruar në zyrën e gjendjes civile në Greqi pa të dhënat e babait dhe me të dhënat e rreme të nënës për sa i përket rubrikës së mbiemrit. Për të vërtetuar mësinë nisi një proces gjyqësor në Greqi, por gjykatat përkatëse atje e rrëzuan kërkesën me arsyetimin se nuk kishin kompetencë të shqyrtonin ekzistencën e lidhjes prind-fëmijë.

TLAS-i për të njëjtën arsye hapi një gjyq në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, me objekt vërtetim fakti. Kjo është gjuhë juridike. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë e rrëzoi këtë kërkesëpadi me argumentimin se akti i gjendjes civile është hartuar në Greqi dhe është shteti grek ai që duhet ta rregullojë atë. Për këtë është bërë ankesë në Gjykatën e Apelit Korçë, e cila gjithashtu la në fuqi vendimin e gjykatës së Shkallës së Parë, Korçë. Në ditët e sotme ky fëmijë ka mbushur moshën 19 vjeç dhe është ende i paregjistruar në regjistrat e shtetit shqiptar. Aktualisht çështja është në Gjykatën e Lartë, është paraqitur rekurs dhe pret të shqyrtohet, por nuk e dimë kur do të përfundojë ky shqyrtim. Për sa i përket partneritetit me institucionet shtetërore ne dëshirojmë të shprehim gatishmërinë dhe falënderimin, sepse financimi i ADN-së u bë i mundur me fonde shtetërore.

Për sa u përket problemeve për zgjidhje, përderisa jemi në një institucion siç është Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, besojmë dhe kemi parasysh tri funksionet që ai kryen:

Së pari, funksionin e përfaqësuesit të të gjitha interesave të shoqërisë shqiptare.

Më lejoni të jap një statistikë. Për një periudhë 15-vjeçare, Shërbimi Ligjor Falas ka bërë të mundur të regjistrojë 7206 fëmijë, të cilët nuk ishin të regjistruar në regjistrat e gjendjes civile. Pra, mesatarisht mund të ndodhë që përfaqësuesit të ekzistojnë diku 5 000 familje, të cilat kishin fëmijë të paregjistruar dhe tashmë u regjistruan. Kjo i përket vetëm një organizate jofitimprurëse, ndërkohë në Shqipëri ka me dhjetëra të tilla që kanë në fokus të veprimtarisë së tyre këtë gjë.

Besojmë dhe vlerësojmë se parlamenti dhe veçanërisht ky grup është forumi më i duhur për të përfaqësuar interesat e tyre. Në fund të ditës, janë shtetas shqiptarë, por edhe sikur të mos jenë, kanë nevojë, sepse kanë të drejta themelore njerëzore, problemet e të cilëve duhen adresuar, zgjidhur dhe i duhet dhënë zgjidhje adekuate. Gjithashtu, vlerësojmë që zgjidhjet në legjislacion duhet të jenë jo zgjidhje iluzive dhe teorike, por zgjidhje praktike në mënyrë që në

afatin më të shkurtër dhe të mundshëm kohor, të vendoset në vend e drejta të paktën, për t'u regjistruar. Prej kësaj të drejte burojnë edhe një sërë të drejtash të tjera.

Funksioni i dytë që kryen parlamenti, është funksioni i kontrollit. Besojmë gjithashtu, se sikundër ekziston parlamenti për çdo pjesë tjetër të legjislacionit në Shqipëri, edhe ky komision *ad hoc* ka mundësi të ushtrojë kontroll parlamentar veçanërisht për këtë çështje që është problematike në realitetin shqiptar, zbatimi në mënyrë të plotë i legjislacionit. Gjykojmë dhe vlerësojmë që sa më shumë të hapet rruga për në BE, aq më shumë do të bëhet permanente kjo pikë e axhendës për zgjidhje. Pra, çështja e pashtetësisë është problem jo vetëm në Shqipëri, por është problem edhe në BE dhe, në rrugën e negocimit, kjo çështje do të jetë patjetër pjesë e diskutimit nëpër tryeza.

Përpos detyrimeve ligjore, që u përmendën pak më parë nga Lorena, Gjykata e Strasburgut ka nxjerrë së fundi një çështje, ku çuditërisht aplikanti ishte gjithashtu shqiptar, Hoti kundër Kroacisë, më 26.4.2018. Pa mëdyshje edhe jurisprudenca e ka konsideruar këtë vendim si një vendim udhërrëfyes për këtë pikë. Konventa Europiane mbron edhe të drejtat e personave pa shtetësi dhe kjo konventë vendos për shtetet detyrimin për t'i regjistruar personat pa shtetësi.

Të kthehemi tani te funksioni primar i parlamentit, funksioni ligjvënës i tij. Ne vlerësojmë dhe gjykojmë se së pari, ka nevojë për ndryshime legislative. Ndryshimet legislative mendojmë se duhet të jenë të fokusuara kryesisht në ligjin për gjendjen civile. Është e nevojshme të bëhet një ndërhyrje në nenin 43, pika 3 të ligjit për gjendjen civile, të miratuar në vitin 2009 në bazë të së cilës të bëhet e mundur në shtetin shqiptar, plotësimi dhe korrigjimi i akteve të gjendjes civile për subjektet, që janë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Pra, t'u japim juridiksion gjykatave shqiptare, që Gjykata e Korçës të mos na thotë më të shkojmë në Greqi dhe të rregullojmë aktin, por të kemi mundësi që këtu, në Shqipëri të vërtetojmë faktin dhe ta rregullojmë këtë çështje para gjykatës shqiptare. Në të vërtetë ne kemi një dilemë në këtë pikë, edhe ne si ekspertë në këtë çështje, nëse kjo mund të bëhet nëpërmjet amendimit të ligjit në gjendjen civile apo amendimit të Kodit të Procedurës Civile, sepse siç dihet, ligji për gjendjen civile është me shumicë të thjeshtë, ndërsa Kodi i Procedurës Civile është me 3/5 e votave. Besojmë dhe vlerësojmë se edhe me këtë instrument është e mundur për ta bërë të ligji për gjendjen civile, sepse sot parlamenti e ka çelur këtë praktikë, e cila është kushtetuese, sepse nuk është atakuar asnjëherë në Gjykatën Kushtetuese. Është rasti i ligjit për masat ndaj dhunës në familje, i cili është miratuar me shumicë të thjeshtë dhe vendos rregulla për gjykatën, që sot zbatohet nga gjykatat në Shqipëri. Si parim i përgjithshëm dhe për çdo

gjë tjetër, nëse një çështje zgjidhet administrativisht, është e rekomandueshme të zgjidhet administrativisht. Në këtë pikë ne vlerësojmë se ndoshta me vendet, ku ka emigracion shumë të madh nga Shqipëria (Itali, Greqi dhe vendet e tjera), të kemi mundësinë e lidhjes së instrumenteve administrative nëpërmjet Ministrisë së Jashtme, por edhe ministrive të përbashkëta, si Ministria e Brendshme për t'i zgjidhur administrativisht këto probleme. Zgjidhja administrative është një zgjidhje më e shpejtë dhe më me pak kosto për individin. Zgjidhja gjyqësore duhet të mbetet si element i fundit për këtë pikë.

Kemi menduar gjithashtu, edhe disa përmirësime të tjera për sa i përket ligjit për gjendjen civile, ku ndërmjet të tjerave propozojmë që në nenin 41, pika 6 të krijohet mundësia e një mekanizmi të përkohshëm. Pra, për të gjithë individët, të cilët lindin në institucione të bëhet e mundur që këto institucione të krijohet një regjistër i përkohshëm dhe pastaj të shihet në këtë regjistër të përkohshëm brenda një kuadri ditor prej 60 ditësh se sa prej këtyre lindjeve të deklaruara në institucionet shëndetësore, janë të regjistruara në regjistrin e gjendjes civile. Brenda 60 ditësh institucioni do të bëjë të mundur një skanim të çështjes dhe do të thotë se një pjesë e këtyre personave që kanë lindur, janë regjistruar dhe pjesa tjetër nuk është regjistruar, por është e identifikuar. Në këtë mënyrë mund të futet shteti me mekanizmat e veta, qoftë me njësitë e mbrojtjes së fëmijëve, qoftë me institucionet e tjera, të cilat do ta çojnë përpara çështjen e regjistrimit. Pra, regjistrimin për individët që kanë lindur në këto institucione e që brenda afatit kohor nuk janë regjistruar në regjistrin e gjendjes civile, do ta marrë në dorë shteti, për sa kohë prindërit qëndrojnë pasivë.

Elementë të tjerë, të cilët kanë të bëjnë me amendime konkrete, besojmë se janë neni 45 paragrafi i tretë i këtij ligji, i cili u jep mundësi gjykatave shqiptare ta shqyrtojnë çështjen brenda dhe jashtë kufijve territorialë të Shqipërisë.

Po ashtu, gjykojmë se është e nevojshme dhe e domosdoshme edhe amendimi i neneve 39 dhe 40 të ligjit për gjendjen civile, ku vlerësojmë se e njëjta zgjidhje që është parashikuar për kategorinë e fëmijëve të braktisur, është e nevojshme të regjistrohet edhe për një sërë kategorish të tjera dhe meqenëse jemi në rastin konkret për fëmijët e paregjistruar, të përfshihen në fushën e veprimit të këtyre dy neneve edhe regjistrimi i këtyre fëmijëve.

Besojmë se edhe kjo do të jetë në vëmendjen tuaj si ligjvënës, sepse në Ministrinë e Brendshme është krijuar një grup pune, i cili po rishikon çështjet e ligjit për shtetësinë. Ndoshta është e nevojshme të shihen te ky ligj edhe disa aspekte të tjera në këndvështrimin tonë, brenda fokusit që ka grupi ynë dhe të bëhet e mundur dhënia e shtetësisë shqiptare fëmijëve që lindin nga të huajt, që qëndrojnë në mënyrë jolegale në Shqipëri.

Shërbimi ligjor falas ka qenë gjithashtu, pjesë e çdo procesi legjislativ.

Së fundi desha të përmend edhe pjesën e reformës në drejtësi, ku ne kemi drejtuar dhe kemi paraqitur opinionet tona për këtë pikë.

Kemi një kërkesë edhe në kuadër të komisioneve të përhershme, edhe në kuadër të grupit, që besoj se do të duhet të shqyrtojë çdo nismë legjislative. E themi këtë nga një eksperiencë disi negative, sepse në vitin 2016 është shfuqizuar një pjesë e ligjit për gjendjen civile (një nen i veçantë i tij), për të cilin ne nuk gjejmë dot arsyen pse është shfuqizuar.

Gjithashtu, gjykojmë se ky shfuqizim nuk ka krijuar asnjë pasojë dhe ne nuk e dimë se përse është shfuqizuar.

Më lejoni të citoj fjalën, kur është shfuqizuar në vitin 2016: “Mundësimi i deklarimit të lindjes pranë përfaqësive diplomatike apo konsullatave të huaja për fëmijët e lindur nga shtetas shqiptarë me banim të përhershëm në Shqipëri, të lindur jashtë territorit të RSH-së, regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në përfaqësitë diplomatike ose konsullore shqiptare, në vendin ku ka lindur.”

Pse është shfuqizuar kjo dispozitë?

Të gjitha këto, i nderuar zoti Kryetar, përbëjnë atë që ne shkurtimisht kemi nxjerrë si ekstrakt i këtij raporti, pra thjesht, disa rekomandime të thjeshta legjislative, të cilat bëjnë të mundur ndryshimin e madh. Ndoshta mund të duket një shprehje, pra pas fjalës “brenda vendit” të shtohet edhe fjala “jashtë vendit”. Është thjesht një fjali në ligj, e cila do të thotë zgjidhje e hallit dhe problemit të mijëra e mijëra fëmijëve, të cilët sot gjenden në gjykata dhe çuditërisht, gjykatat shqiptare po mbajnë ende standarde të dyfishta për problemin e tyre. Ju përmenda pak më parë rastin e Gjykatës së Korçës, e cila pret rekursin në Gjykatën e Lartë, çuditërisht me të njëjtat kushte dhe me të njëjtin arsyetim Gjykata e Shkodrës e pranoi regjistrimin e një fëmije.

Gjithsesi, gjykojmë dhe vlerësojmë se së pari mjeti është legjislativ. Duhet bërë ndryshimet legjislative në këtë pikë dhe më pas të fillojë ndërgjegjësimi, monitorimi dhe zbatimi i të gjitha këtyre kriterëve dhe praktikave që kemi.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Viktor dhe zoti Vangjel për gjykimet dhe vlerësimet tuaja!

Kush ka pyetje dhe më pas, mendime?

Do t'ju lutesha që pyetjet t'u adresoheshin ekspertëve, në mënyrë që ata të mund të kontribuojnë se çfarë do të bëjmë më tej. Kjo për të qartësuar edhe veten dhe se çfarë do të bëjmë ne më tej.

Urdhëroni, Vasilika!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Shumë faleminderit, zoti Gumi për prezantimin!

Unë kam një pyetje shumë konkrete. Ju si ekspert, së bashku me UNHCR-në, a keni një paketë propozimesh konkrete të ndryshimit të të gjitha ligjeve, të cilat kanë të bëjnë me pashtetësinë? Nëse po, a është diskutuar mes jush dhe a u është përcjellë institucioneve përkatëse?

Këtu kemi të gjithë përfaqësuesit e 6 ministrive përgjegjëse. Ata janë në nivel zëvendësministrash. Kështu, ndoshta do të ishte mirë për të fillonim një diskutim në muajin shtator.

Viktor Gumi – Faleminderit, zonja Hysi!

Ne besojmë se një pjesë të paketës së përditshme, të cilën për efekt kohe e paraqitëm këtu, e kemi të gatshme. Pra, për ndryshimin përkatës, që ka të bëjë me ligjin për gjendjen civile, besojmë se i kemi identifikuar nenet dhe i kemi të gatshme formulimet e tyre. Në projektraport janë paraqitur në marrëdhënie më të përgjithshme, sepse gjykojmë se kur të përkthehet projektraporti në gjuhë legislative ka nevojë për një gjuhë të brendshme brenda vetë organizatave fitimprurëse, për ta qartësuar çështjen, sepse kjo është vetëm eksperiencë e TILAS-it, por ndërkohë procesi legjislativ ka nevojë të kemi mundësinë për një konsultim edhe me shoqatat e tjera për ta paraqitur atë në një formë më zyrtare.

Për sa i përket çështjes tjetër, ne jemi në dijeni se Ministria e Brendshme ka ngritur një grup pune të posaçëm për të punuar ligjin për shtetësinë për shtetësinë shqiptare dhe atë për të huajt. Presim që ky grup pune të nxjerrë produktin e tij. Sipas ligjit për konsultimin publik, ai duhet të bëhet publik dhe të pritët një periudhë 30-ditore për komente. Ne jemi të gatshëm të paraqesim komente për këto projektligje.

Në lidhje me pyetjen e parë, ne, si shoqatë i kemi të gatshme propozimet legislative. Gjykojmë dhe vlerësojmë, se duhet një raund konsultimi brenda *network*-ut të OJF-ve për të konsoliduar qëndrimet që të mos ketë qëndrime të ndryshme apo shtesa të tjera. Sapo ta kemi gati, ne do të jemi gati t'i përgjigjemi në çdo kohë ftesës së ministrisë.

Vasilika Hysi – Unë e dëgjova edhe nga zoti Pablo, por edhe nga ekspertët, edhe nga materialet që keni shpërndarë, se bëhet fjalë jo vetëm për ligjin për gjendjen civile, jo vetëm

për ligjin për të huajt dhe atë për shtetësinë, por ju flisni edhe për një ligj të veçantë për pashtetësinë. A i qëndroni idesë se duhet të ketë një ligj të veçantë për pashtetësinë, apo procedura mund të rregullohet nëpërmjet ndërhyrjeve në Kodin e Familjes, në ligjin për gjendjen civile, në ligjin për të huajt dhe në atë për shtetësinë? Do të ishte mirë që këto të vijnë si paketë, që të mos ndodhë ajo që ka ndodhur në vitin 2016, siç thoni ju, sepse unë e mbaj mend debatin e bërë në Komisionin e Ligjeve për këtë amendim që është bërë për regjistrimin e fëmijëve pranë konsullatave.

Viktor Gumi – Po, ne besojmë gjithashtu, se është e rëndësishme për t'u bërë edhe pjesa e pashtetësisë. Në të vërtetë identifikimi i mjetit përkatës, nëse duhet një ligj i veçantë apo do të duhet një kapitull i veçantë në një ligj tjetër, kjo është çështje e teknikës legislative për të nxjerrë instrumentin, por në parim raporti ka identifikuar se ekziston një *gap* dhe mungon procedura administrative përkatëse për çështjen e pashtetësisë në mënyrë të rregulluar me ligj. Është pjesë e projektit për ta rregulluar. Po hartojmë dispozita dhe jemi në konsultim për këtë pjesë.

Nëse ky do të jetë ligj i veçantë apo do të jetë i inkuadruar si rubrikë e veçantë, si kapitull i veçantë në një ligj tjetër, kjo i përket fazës më të fundit të teknikës legislative. E kemi identifikuar si problem dhe ka nevojë të adresohet së pari, nga shteti shqiptar dhe nga organizatat në ndihmë të tij.

Lorena Isla Rodriguez – Për të shtuar dhe për të vazhduar atë që përmendi edhe kolegu, më 8 qershor ne kemi bërë një prezantim me ministrinë e linjës që janë të përfshira. Ministrinë kanë marrë pjesë edhe në hartëzimin e kësaj çështjeje dhe këtu përfshihet edhe Ministria e Shtetit për Diasporën, Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme dhe patjetër, edhe Ministria e Arsimit. Normalisht është bërë një diskutim edhe me këto ministri, janë identifikuar çështjet problematike apo mungesat në ligjet përkatëse, siç është Kodi i Familjes, ligji për gjendjen civile e të tjerat. Kështu, edhe konsultimi me ministrinë në këtë kuadër, është ndërmarrë tashmë.

Elona Hoxha Gjebrea – Falënderoj edhe përfaqësuesit e UNCHR-së dhe të gjithë ata që kanë punuar për këtë studim! Mendoj se është një fenomen shumë i rëndësishëm, i cili duhet adresuar. Personalisht mendoj se ligji për shtetësinë, është një ligj që ka nevojë për ndryshime. Ndoshta ky është momenti që të kemi një paketë të konsoliduar, siç tha edhe nënkryetarja.

Kam dy pyetje. Pyetja e parë, ka të bëjë me përfaqësuesit e UNCHR-së, meqenëse ata janë marrë me krahasimet. A është ky një fenomen shqiptar apo ka edhe vende të tjera, të cilat kanë probleme me shtetësinë?

Nga ana tjetër, meqenëse pashë aty që Greqia dhe Gjermania janë dy vendet më të prekura nga ky fenomen, a keni bërë vizita apo tentativa për bashkëpunim me përfaqësuesit e këtyre vendeve dhe a keni diçka për të thënë në lidhje me këtë? Ndoshta përfaqësuesit e Ministrisë së Jashtme dhe ata të Ministrisë së Brendshme mund të japin një përgjigje për këtë çështje.

Pablo Zapata Olivares - Faleminderit, zonja Gjebrea!

Ky fenomen nuk është jo vetëm në Shqipëri, por është një fenomen në të gjithë botën. UNHCR me studimet që ka bërë në të gjithë botën, ka nxjerrë se ka 10 milionë veta pa shtetësi. Arsyet janë të ndryshme, për shembull në ish-Bashkimin Sovietik ka pasur probleme me legjislacionin e ish-Bs-së dhe më pas me legjislacionin e republikave, që kanë lindur nga BS-ja. Ka një mangësi në legjislacion.

Në rastin e Shqipërisë ka lidhje me dy fenomene që nuk janë specifike vetëm për Shqipërinë, si situata e romëve dhe e egjiptianëve dhe situata e diasporës shqiptare. Në të gjitha vendet ka zgjidhje të ndryshme, por në të gjitha vendet e botës ka nevojë për ndryshime legjislative, ndoshta jo në çdo shtet, por në pjesën më të madhe të tyre. Tani në UNCHR kemi ftuar shtetet për ta përfunduar fenomenin e pashtetësisë në vitin 2024.

Zoti Majko, kur kemi qenë në prezantim, tha se viti 2024 është shumë larg, në një kohë kur në Shqipëri kemi punuar dhe i kemi identifikuar çështjet legjislative dhe administrative që duhen? Ndoshta është e domosdoshme të ecim pak më shpejt, jo kaq avash dhe të jemi një shembull jo vetëm në Europë, por edhe në botë.

Faleminderit!

Nora Malaj - Faleminderit, zoti Kryetar!

Ju falënderoj për këtë tryezë, e cila mendoj se vjen në një moment shumë të rëndësishëm, në kohën dhe në vendin e duhur!

Zoti Gumi, desha t'ju bëj një pyetje. Kur kemi studiuar fenomenin e braktisjes së shkollës dhe kemi fokusuar pikërisht komunitetin rom dhe atë egjiptian, u vu re një fenomen në kuadër të studimit, që lidhej me martesat e hershme të këtij komuniteti, të cilat krijojnë një problematikë shumë të madhe. Këtë studim e kemi bërë në partneritet me UNICEF-in dhe me Observatorin e Mbrojtjes së Fëmijëve. U vërejt se këto martesat të hershme ndodhnin në momentin kur vajzat e mitura largohen nga shkolla, pra e braktisin atë.

Nga ana tjetër, fëmija që lind, mbetet i paregjistruar dhe situata krijon këtë problematikë, e cila më pas nuk merr dot zgjidhje. Pyetja është: Si mundet që në këtë paketë ligjore të futet edhe kjo kategori, duke pasur parasysh që të specifikohet problemi, në mënyrë që ai të adresohet i plotë dhe vendimmarrja dhe ndihma që do të jepet, të jetë e mbështetur edhe në Kushtetutë?

Gramoz Ruçi – Urdhëroni, zoti Vangjel!

Vangjel Kosta – Po përgjigjem unë, meqë e kemi përgatitur së bashku me Viktorin këtë material. Ky është një fenomen vërtet shqetësues me të cilin ekspertët e klasit janë ndeshur prej shumë vitesh, në ato shifra që prezantoi Viktori dhe një pjesë e madhe u përket edhe këtyre fëmijëve.

Unë dua ta filloj me një prezantim më të përgjithshëm. Në legjislacionin tonë kemi sistemin e delegimit të detyrimit për regjistrim nga familja (nga prindi dhe të afërmit). Nëse ata nuk reagojnë në kohën e duhur, legjislacioni parashikon ndërhyrjen e shtetit. Në këtë pikë ka disa rekomandime përmirësuese, pikërisht për të plotësuar boshllëkun e dytë, sepse ne kemi shumë raste ku prindi nuk reagon dhe shteti nuk ndërhyr për shkak të ndarjes që krijohet në legjislacion.

Problemi që sapo prezantuam lidhet pikërisht me pjesën e dytë. Pra, ne kemi nëna që për arsye të ndryshme, sidomos nga ky komunitet, nuk e ushtrojnë përgjegjësinë që ligji u ngarkon për të regjistruar fëmijën, sepse shpesh në komunitet ekziston mentaliteti që regjistrimi i fëmijës nuk shihet si një e drejtë e fëmijës dhe si një detyrim i prindit, por shihet i një e drejtë e prindit që thotë se është fëmija e tij, prona e tij dhe ai bën ç'të dojë me të.

Rastet më të vështira që kemi pasur kanë qenë, kur nëna lind fëmijë me një person, të cilin nuk mund ta regjistrojë si baba, ngaqë ky person ushtron presion që ajo mos ta regjistrojë fëmijën, nëse ai nuk regjistrohet si baba. Këtu nga kjo e drejtë e fëmijës për t'u regjistruar nga ata prindër, të cilët vërtet mund të jenë prindër biologjikë, por kanë vështirësi për ta realizuar regjistrimin, krijohet edhe shqetësimi që ju prezantuam.

Ne besojmë se mekanizmat që janë propozuar si mekanizma plotësuese, do të përfshijnë zgjidhjen e çështjeve, që ju sapo prezantuam.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Ka pyetje tjetër?

Të lutem, përsërite përgjigjen e pyetjes së dytë!

Elona Hoxha Gjebrea – Zoti Kryetar,

Kisha dy pyetje. Për pyetjen e dytë nuk mora përgjigje. Nëse mundet, të më japë një përgjigje zëvendësministri!

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Ia thoni edhe një herë!

Elona Hoxha Gjebrea – Besoj se e kam të qartë.

Gramoz Ruçi – Urdhëroni, zonja Romina!

Romina Kuko – Faleminderit zoti Kryetar!

Zonja Gjebrea,

Lidhur me çështjen, janë ndërmarrë hapat apo demarshet nga Ministria e Brendshme për të komunikuar në nivel bilateral me shtetet, sidomos me Greqinë dhe me Gjermaninë, të cilat paraqesin këtë problematikë. Duke filluar nga nëntori i vitit të kaluar kemi bërë disa vizita në nivel zëvendësministrash në vendet e rajonit, në Gjermani e në Francë, sepse këto fenomene janë sigurisht të lidhura edhe me fenomene të tjera, siç është çështja e azilkërkimit, emigracioni i paligjshëm etj.

Në nivel bashkëpunimi policor kemi vendosur një nivel komunikimi shumë të mirë, madje kemi ndërmarrë edhe hapat për krijimin e instrumenteve administrative si marrëveshjet me Gjermaninë dhe me Francën. Komunikimi është i vazhdueshëm. Tani jemi në nivelin e mbledhjes së të dhënave, sepse një nga problemet më të mëdha është çështja e mbledhjes së të dhënave. Ne i marrim informacionet pas faktit kur ai ka ndodhur dhe nuk kemi mundësi t'i parandalojmë, prandaj edhe në nivel bashkëpunimi policor jemi duke i shkëmbyer të dhënat me policitë përkatëse të vendeve të tjera.

Doja të sugjeroja që ne t'i vazhdojmë këto hapa. Kjo është një çështje që u diskutua me Komisioneren për të Drejtat e Njeriut në KE, zonjën Miatoviç shumë gjerësisht. Ndoshta edhe në bashkëpunim me deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, mund të bëjmë vizita bilaterale për të parë edhe nivelin e bashkëpunimit policor dhe atë ligjor, që të shohim se çfarë mund të shtyjmë më tej në këtë çështje.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Ka pyetje tjetër?

Urdhëroni!

Erinda Ballanca – Unë e falënderoj jashtëzakonisht grupin që ka bërë këtë studim, sepse duket që është i thelluar dhe shumë profesional. Ai që e njeh fushën, mjafton të dëgjojë përmbledhjen që bëri zoti Gumi dhe vërtet kupton se cilat janë problematikat. Ajo që më tërhoqi më shumë vëmendjen dhe si të themi, si profesioniste e fushës së drejtësisë, është se zgjidhja

e vetme që u dha vazhdon të mbetet dërgimi i çështjeve në procedura gjyqësore. Kuptohet, se nëse do të shkojmë në gjyq, do të jemi në kundërshtim me parashikimet e konventës e cila thotë se çdo fëmijë ka të drejtë dhe duhet të regjistrohet në vendin ku bëhet regjistrimi, të ketë të drejtën të marrë një kombësi.

Nëse çështja do të shkojë në procedura gjyqësore, në rastin më të mirë, më ideal, ai do të vazhdojë të jetë pa shtetësi, i paregjistruar dhe i pa mundur të marrë pjesë në shkolla etj. të paktën për një periudhë 3-vjeçare. Ndaj, ndoshta do të duhej të kishim një tryezë pak më teknike, kur të diskutohet ligji, ku të parashikojmë ndonjë mundësi të ndonjë procedure administrative, e cila do t'u lejojë këtyre personave që në kohën e ndërmjetme të kenë një identitet, të regjistrohen, të shkojnë në shkollë dhe të bëjnë ndonjë gjë. Pra, të kenë ndonjë lloj të drejte apo ndonjë lloj regjistrimi provizor, i cili duhet të konfirmohet në një mënyrë, ndoshta për efekt identifikimi, nëse është apo nuk është fëmija i një prindi shqiptar të themi, që të ketë mundësi që nëse bëhet analiza e ADN-së dhe kjo del pozitive, të bëhet regjistrimi. Nëse ka ndonjë njeri ndonjë kundërshti, të bëjë gjyq për t'ia hequr shtetësinë. Pra, të gjejmë ndonjë procedurë administrativisht, e cila do t'u japë këtyre fëmijëve një akses më të lehtë në shërbimet e përgjithshme, sidomos, po flas për kategorinë e fëmijëve që kanë lindur dhe jetojnë jashtë vendit, sepse për kategorinë e fëmijëve të lindur rishtaz, më pëlqeu shumë propozimi që të ketë një lloj mbikëqyrjeje, një kalim të dhënash gjë që sot, në erën dixhitale është e mundur, që nga spitalet dhe përgjithësisht (me njohjet e mia), ekziston kultura e lindjes në qendrat spitalore, kjo do të jetë zgjidhja e një problemi. Do të jetë një problem më i vogël se është i vogël numri i fëmijëve, të cilët nuk lindin në qendra shëndetësore, por lindin jashtë këtyre qendrave. Po kështu, edhe identifikimi i tyre dhe ndërhyrja për t'i trajtuar këta fëmijë me prioritet. Gjithsesi, besoj se fenomeni do të jetë më i vogël.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Ka pyetje tjetër?

Romina Kuko – Mund të shtoj edhe diçka?

Gramoz Ruçi – Urdhëroni!

Romina Kuko – Në dijeninë time, një problematikë ka të bëjë edhe me mospagesën në maternitet nga gratë, kryesisht rreth në momentin që ato lindin dhe largohen me fshehtësi pikërisht për këtë arsye. Ndoshta, mund të vendoset një fond nga Ministria e Brendshme për këtë situatë emergjente në mënyrë që në momentin që bëhet pagesa merr edhe certifikatat nga maternitetet.

Gjithsesi ngritja e një grupi ekspertësh dhe grupi pune, aq më tepër që këtu kemi një seri me institucione të cilat merren me këtë fushë, do të ndihmojë në adresimin, i cili mendoj se është një problem në disa drejtime. Nuk bëhet fjalë vetëm për këtë moment që unë përmenda, por e mora thjesht si shembull.

Faleminderit!

Edlira Bode - Faleminderit!

Vetëm një sqarim të vogël, Elona, për pagesë bëhet fjalë vetëm tek institucionet private. Gratë që lindin, gjatë gjithë shtatzënisë, edhe shërbimin shëndetësor për lindjen në institucionet publike e kanë falas.

Elona Hoxha Gjebrea – Po flas për fëmijët që lindin në Greqi.

Vasilika Hysi – Unë kam një pyetje për Ministrinë e Shëndetësisë.

Një nga shqetësimet që lexova nga raporti është Regjistri Elektronik i Lindjeve dhe ka një asistencë që po jepet. A ka ndonjë zhvillim pozitiv dhe a ka ndonjë pengesë për të hartuar një regjistër elektronik të lindjeve të fëmijëve? Meqenëse këtu kemi edhe drejtorin e përgjithshëm të Gjendjes Civile, a ka ndonjë përpjekje apo ndonjë veprimtari të përbashkët për të unifikuar ose për të përcjellë të dhënat nga maternitetet, qofshin këto publike apo private, drejt Gjendjes Civile?

Ne kemi edhe reformën e derregulimit. Besoj se nuk ka nevojë për shpenzime dhe pagesa, në qoftë se institucionet komunikojnë me njëra-tjetrën.

Faleminderit!

Bardhylka Kospiri - Faleminderit!

Unë do të doja të sqaroja dy aspekte, përtej pyetjes që zonja Hysi bëri.

Së pari, Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale është angazhuar në të dyja drejtimet lidhur me problematikat, duke përfshirë edhe këtë problematikë specifike.

Për sa i përket pjesës së identifikimit përtej punës që bën Ministria e Brendshme për identifikimit të fëmijëve në këto situata, ne kemi rrjedhën e njësisë të NJMF-ve pothuajse në të gjithë vendin, të cilat kanë detyrë dhe e zbatojnë në bazë të ligjit të fundit për mbrojtjen e fëmijëve, që të paraqesin rastet dhe t'i orientojnë për zgjidhje lidhur edhe me këtë situatë.

Që nga viti i kaluar ka rezultate, pra NJMF-të janë marrë me raste të tilla dhe ua kanë bërë prezente institucioneve përkatëse rastet e fëmijëve që vijnë nga situata të tilla, të paregjistruar apo pa nënshtetësi.

Për sa i përket pjesës së shëndetësisë unë do të thosha se shërbimin shëndetësor falas e marrin të gjithë, pavarësisht se janë apo nuk janë të regjistruar dhe janë apo nuk janë nënshtritur, në shërbimin e urgjencës të çdo qendre shëndetësore, pra nuk mbeten pa shërbim shëndetësor.

Për sa i përket regjistrimit dhe ndërlidhjes së sistemeve, ato janë në proces dhe jo vetëm në këtë drejtim, por po ndërveprohet bashkë me mbështetjen e UNICEF-it, po punohet që kjo të ndodhë. Procesi është në vijim dhe një nga rezultatet e këtij procesi do të jetë edhe mundësia që do të kemi për identifikimit të rasteve.

Jawad Aslam – Normalisht, UNICEF-i ka bashkëpunuar dhe vazhdon të bashkëpunojë me entitetet qeveritare, me drejtoritë e ndryshme të ministrive të linjës, me Ministrinë e Shëndetësisë, gjithashtu edhe me shoqërinë civile dhe me organizatat e shoqërisë civile. Është bërë vlerësimi i regjistrimit në lindje dhe sistemit të regjistrimit në lindje dhe aktualisht po krijojmë një model për regjistrimin në lindje, i cili do të pilotohet në tri bashki. Pas pilotimit të këtij sistemi të regjistrimit në lindje në këto tri bashki, UNICEF-i së bashku me partnerët e tij do të bëjë një propozim për zgjerimin dhe shtrirjen e sistemit në nivel kombëtar.

Robert Gajda – Unë kisha diçka që ndoshta duhet t'ia drejtoj përfaqësuesit të Ministrisë së Jashtme, sepse në bazë të statistikave shihet se pjesa më e madhe e pashtetësisë vjen nga lindjet jashtë Shqipërisë, ku evidentohen tre shtete, Greqia, Gjermania dhe Kosova.

Në dijeninë time vendi i dytë ku ne mund të kemi emigrantë është Italia, po këtu nuk figuron, dhe me sa duket atje mund të jetë i zgjidhur ky problem. Pse evidentohet më shumë Greqia dhe jo Italia? Mos ndoshta duhet të intensifikojmë marrëdhëniet dhe të gjejmë arsyen pse në Greqi ndodh fenomeni dhe në vende të tjera ku ne kemi të njëjtat problematika nuk ndodh?

E dyta është aspekti krahasimor. Në rajon, të paktën edhe nga prezantimi që i është bërë raportit, është evidentuar që janë gjetur disa zgjidhje ligjore në vendet fqinje. A janë reflektuar këto praktika krahasimore të vendeve të tjera? A janë reflektuar këto aspekte ligjore që mund t'i kenë dhënë ndreqje këtyre situatave në propozimet që po reflektojmë këtu? A do të ishte mirë që të hulumtonim më shumë në lidhje me këto çështje?

Artemis Dralo - Faleminderit!

Më lejoni, që për pyetjen e parë, që ka lidhje me statistikën, t'ju sqaroj pozicionin e Ministrisë së Jashtme!

Ministria e Jashtme është në rol koordinues, jo vetëm të të dhënave dhe të shifrave të ardhura, jo vetëm nëpërmjet ministrive të linjës, por kryesisht burim kryesor janë të dhënat dhe

shifrat, që na vijnë nga ambasadat tona jashtë. Gjithashtu, kjo ministri është rolin koordinues të gjithë procesit të hartimit të këtyre raporteve që ne i paraqesim dy herë në vit.

Pra, ky raport për të drejtat e fëmijës, në bazë të Konventës për të Drejtët e Fëmijës do të paraqitet brenda vitit 2018 dhe i ka të përfshira të gjithë të dhënat e ambasadave në mënyrë zyrtare, në bashkëpunim kryesisht me Ministrinë e Brendshme, por edhe me gjithë ministrinë e linjës janë të përfshira në këtë proces.

Për sa i përket burimit të shtetit, që ju e përmendët, Italia ose Greqia, për këtë nuk mund të kemi një zyrtar për sa kohë shifrat zyrtare janë të tilla.

Arsyet se përse është reduktuar numri i të regjistruarve ose të paregjistruarve në një nga këto dy shtete janë të argumentuara në bazë, nëpërmjet ambasadave. Të dhënat që na vijnë nga këto ambasada janë ato lindje që ndodhin në këto shtete, të cilat legalizohen nëpërmjet ambasadave tona me të drejtën e vetë qytetarëve shqiptarë, që jetojnë në këto dy shtete, që do të thotë se është zgjedhja e dokumentacionit që ata kanë, lejes së qëndrimit, nënshtetësisë që ata kanë përfituar dhe një sërë dokumentacionesh të tjera.

Pra, në rastin konkret të gjitha këto statistika që vijnë nga ambasadat pasqyrohen në Ministrinë e Brendshme dhe në koordinim me Ministrinë e Jashtme përpilohet ky raport, i cili aktualisht duhet të përfundojë brenda vitit 2018 për t'u raportuar.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – A ka pyetje tjetër?

Urdhëroni!

Romina Kuko – Lidhur me sistemin që jeni duke pilotuar në bashki, duke qenë se Ministria e Brendshme ka, gjithashtu, portofolin e pushtetit vendor, unë e kuptoj se ai është funksion i deleguar, por është e rëndësishme që ju të rakordoni punën me Ministrinë e Brendshme, sepse ajo që ndodh nganjëherë është që, me gjithë dëshirën e mirë, donatorët duan të pilotojnë diçka, por pastaj kemi mbivendosje të këtyre sistemeve, ndërkohë që ajo na intereson është të kemi një sistem kombëtar në të cilin të kemi një palë të dhëna dhe nuk mbivendosim të dhënat mbi njëra tjetrën.

Kështu që, ju lutem, komunikoni edhe me Ministrinë e Brendshme që të rakordojmë, sepse ka një projekt për stabilizimin e *One Stop Shop*-eve dhe duhet të shohim se si qëndron projekti juaj konform kësaj.

Faleminderit!

Jawad Aslam – Patjetër, zonja zëvendësministre, e mora shënim komentit tuaj dhe do të vazhdojmë të ndjekim çështjen në këtë kuadër.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Unë marr letra, marr telefonata, marr e-maile, ku ka shumë probleme. Tri telefonata kam marrë për problemin për të cilin jemi mbledhur sot dhe, të them të drejtën, më është dukur vetja një UFO. Një qytetar do të regjistrojë fëmijët dhe unë, Kryetari i parlamentit, nuk i jap dot as ndihmë dhe nuk mund t'i tregoj dot as rrugën, përveçse atë të gjykatës, fati i të cilëve është ai që përsëriti zoti Viktor. Një fëmijë e kishte 12 vjeç, kurse tjetrin 16, ndërkohë që është në dilemë të vijë apo të mos vijë, dhe më lutet si do t'i ndihmoj për t'i regjistruar. Kaq. E thjeshtë fare.

Po të ishte një rast, sigurisht që nuk do të ishim mbledhur për këtë problem, por janë qindra dhe mijëra raste. Unë, sigurisht që, me sinqeritetin më të madh do të falënderoja, edhe një herë UNICEF-in, UNHCR-në, TLAS-in, shoqërinë civile, e cila na e shfaqti problemin për kaq sa kanë evidentuar, por unë dyshoj se s'është vetëm kaq. Duhet të jetë më i madh për të mos thënë “me herë” dhe kjo mbledhje duhet të japë alarmin te ne si ekzekutiv, duhet të japë alarmin te ne si ligjvënës. Jemi ne që duhet t'i zgjidhim gjërat.

Shpesh ne ligjvënësit dhe ju të nderuara e të nderuar përfaqësues të ekzekutivit dhe institucioneve qendrore dukemi sikur merremi me probleme të mëdha dhe harrojmë ato që në dukje duken si të vogla ose s'duken asgjëkund. Po vendoseni një herë veten në vend të atyre prindërve që kanë fëmijë të paregjistruar. A do të kishit problem më të madh?

Parë në këtë këndvështrim asnjë deputet shqiptar dhe asnjë ministër i ekzekutivit shqiptar nuk e ka parë këtë problem, prandaj problemin do ta pozoja në tre drejtime kryesore, që jo vetëm të mbjellim e të mos korrim.

Ky grupim do të mblidhet në fund të shtatorit ose maksimumi java e parë e tetorit dhe rendi i ditës do të jetë çfarë do të korrim nga këto që thamë. Sot mbollëm, po çfarë do të korrim? Cila është përgjigjja që do t'u japim për zgjidhje? Gjëja e parë që do të thosha është që për këtë situatë, në radhë të parë të sensibilizojmë opinionin publik, por përpara duhet të sensibilizojmë ligjvënësit shqiptarë dhe administratën shqiptare.

Secili nga ne që është këtu, që nga unë që jam Kryetar parlamenti dhe ju, përfaqësues të institucioneve dhe të ministrive, duhet ta konsiderojmë veten nxënës. T'i marrim të gjitha këto materiale dhe t'i bëjmë tonat. Cilat janë konventat? Cili është legjislacioni ynë? Cilat janë përgjegjësitë tona, sipas dikastereve, Ministria e Jashtme, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë e kështu me radhë për çdo regjistrim?

Unë po marr dy angazhime, ju jeni zëvendësministra të gjithë, zonja Hysi dhe unë, në qoftë se anëtarët e grupit “Miqtë e Fëmijëve” nuk do të bëhen promotorë për të thirrur ministrin

vetëm për këtë çështje që ka diskateri i tij, në seancë pyetje, interpelancë apo mocion në Kuvend, do ta bëj unë si Kryetar Kuvendi apo zonja Hysi si nënkryetare Kuvendi. Të mos kemi fjalë pas 1 tetorit!

Zoti Viktor, nënvizoi tri gjëra, jo pa qëllim. Pavarësisht nga funksioni që kryen tani, ai e di mirë se cili është roli ynë dhe në mënyrë modeste tha: “Jemi përfaqësues të interesave të të gjithë qytetarëve”. Vërtetë unë në fillim përshëndeta grupin “Miq të Fëmijëve”, por po ta shikojmë, pavarësisht se është fund sesioni, të pozuar me problemin e madh që kemi, numri i ligjvënësve nuk është ai i duhuri. Po të shohim ministrat, nuk i paragjykoj zëvendësministrat që janë këtu, përjashtoj zotin Majko, të tjerët e kanë quajtur një punë “e të tjerë”, prandaj po e nënvizoj përsëri, që duhet të njohim në thelb çështjen dhe të bëjmë secili detyrën e vet.

E dyta, kur flas për detyrën e secilit, kam parasysh që këtu ka vend për ligjbërësin shqiptar, ka vend mendimi që duhet të japë, ka edhe aprovimi. Atëherë, ju lutem shumë, të gjashtë dikastereve që janë këtu, UNICEF-it, UNHCR-së, TLAS-it, angazhimi që zoti Guma dhe zoti Kosta morën këtu, përgatituni që në mbledhjen e fundshtatorit apo fillimtëtorit ne të kemi një draft!

Kur flas për një draft, flas për një paketë. Të mos themi që hajde të bëjmë këtë ndërrim apo këtë ndryshim, pasi këto ndërrimet nuk e zgjidhin problemin. Duhet të bëjmë paketën. Firmëtarët duhet të jenë anëtarët e grupit “Miq të Fëmijëve”, me qëllim që sesionin e ardhshëm, të mos ketë probleme ligjore për të zgjidhur këtë çështje.

Unë mendoj se këto duhet të jenë përfitimet e këtij takimi, por më e rëndësishmja është që, edhe një herë e theksoj, fundi i shtatorit apo fillimi i tetorit do të mblidhemi jo për të thënë këto që thamë sot, por për të bërë këto që thamë sot.

Ju falënderoj për kontributet dhe për angazhimin tuaj! Vera do të jetë e nxehtë, por këtë problem mos ta harrojmë, se para syve tanë, atje ku do të pushojmë, do të kemi fëmijë pa shtetësi, të paregjistruar.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA